



Programi i studimit për **Konstruksione** ju jap njohuri dhe ju përgatitë që pas përfundimit të studimeve ju do të jeni në gjendje të projektoni dhe llogarisni Struktura të objekteve ndërtimore, njiheni me materialet e ndërtimit, të shfrytëzoni softwerët profesional **AutoCAD, Sofistik, Robotmilenium, Etabs** etj.

Programi i studimit për **Hidroteknikë** do të ju jap njohuri dhe ju përgatitë që pas përfundimit të studimeve do të jeni në gjendje që të projektoni dhe llogarisni nevojat Hidraulike për objektet, njiheni me materialet e ndërtimit në Hidroteknikë, të shfrytëzoni softwerët profesional **AutoCAD**.

Programi i studimit për **Gjeodezi** do të ju jap njohuri dhe ju përgatitë që pas përfundimit të studimeve do të jeni në gjendje që të përdoreni dhe shfrytëzoni instrumentet gjeodezike të teknologjisë më të re, shënimeve në kadastrat e Kosovës apo edhe punë të lidhura me ndërtimin. Gjithashtu do të njiheni me softwerët profesional për shkencat e Gjeodezisë.

Programi i studimit për **Inxhinieri të Ambientit** do të ju jap njohuri dhe ju përgatitë që pas përfundimit të studimeve do të jeni në gjendje që të bëni vlerësime ambientale për nevojat e objekteve që kanë funksione të ndryshme. Do të njiheni me ndikuesit ambiental inxhinierik, elementet e nevojshme për rritjen e performancës ambientale si dhe njohuri të përgjithëshme të nevojshme për ambientin.

Ne, me punën tonë Institucionale, ju ofrojmë jetë sociale të lidhur me realitetin, aktivitete të zhvillimit të njohurive në terrene në vend dhe jashtë vendit, shërbime të shpejta administrative si dhe hapje e mundësive të reja për avancime shkencore dhe profesionale.

Stafi jonë akademik numëron emra me potencial shkencorë. Stafi jonë, të rinj në moshë ishin studentët tanë të cilët janë në vazhdim të arritjeve të karrierës dhe ata me kontributin e tyre janë promovues të rritjes së cilësisë në Institucionin tonë.

Kujdestar të cilësisë do të jemi gjithmonë NE, që dija juaj të jetë e vlerësuar drejt, arritjet e juaja të shtyhen në zhvillime reale, diploma e juaj të ketë njohuri ndërkombëtare.



- **Konstruksione**
- **Hidroteknikë**
- **Gjeodezi**
- **Inxhinieri e ambientit**

**Kontakti Adresa: Rr. "Agim Ramadani",  
Ndërtesa e Fakulteteve Teknike,  
p.n. 10 000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Telefoni: +383(0)38 554 899 ext.103  
Email: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)  
Web: <https://fn.uni-pr.edu/>**

# Rreth nesh!

Fakulteti i Ndërtimtarisë i Universitetit të Prishtinës është institucioni më i vjetër dhe më i madhi në fushat e Ndërtimit në vendin tonë. Fakulteti jonë ka traditë të pasur të aktiviteteve të saja duke numëruar punën që nga fillimi i themelimit në 1961.

Ky vit, 2021 konsiderohet jubilar duke numëruar **60 vite pune** nga themelimi. Inxhinierët të cilët kanë përfunduar studimet në Fakultetin tonë numërojnë të arriturat në fushat shkencore, në projektme të objekteve të llojllojshme, ndërtime të objekteve të ndryshme.

Janë shumë shërbime të cilat Inxhinierët janë në gjendje të ofrojnë për tregun e punës sikur, projektimi i strukturave, projektimi i sistemeve dhe impianteve ujore, shërbime gjeodezike, vlerësime të mjediseve, mbikëqyrje profesionale, vlerësime të ndryshme të projekteve dhe objekteve si dhe shumë punë të tjera që lidhen me profesionin sikur janë konsultat, vlerësimet e shpejta, identifikimi i rrezeve nga fenomenet natyrore. Shumë nga kuadrat tona janë pjesë e shumë kompanive me renome në rajon dhe Botë si dhe në institucione, përkatësisht Universitete të njohura arsimore.



Pa inxhinierët e Ndërtimit (Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi, Inxhinieri e Ambientit) dhe veprat e tyre, njerëzimi do ta kishte jetën më të vështirë. Duke ndërtuar rrugë që kalojnë pengesa natyrore, rrjedha të lumenjve, penda ujore, objekte për nevojat e njerëzimit - Stadiume, Salla sportive, Objekte të kulturës, lidhje GPS, GPRS dhe të tjera njerëzimit i bëhet jeta më e lehtë, duke u zhvilluar më shpejt në kohë, duke plotësuar nevojat e veta për një jetë të përsosur. Zhvillimi i programeve të studimeve është i bazuar në kërkesat e tregut të punës. Pas përfundimit të studimeve hapen rrugët për punësime në tregun e punës në vend dhe jashtë vendit, si dhe mundësia e madhe e vazhimit të mëtejshëm të studimeve shkencore dhe profesionale.

Fushat e Inxhinierisë së ndërtimit formësojnë Botën ku ne jetojmë. Njohurit e disiplinave shkencore inxhinierike na shërbejnë për jetë më të mirë, më të lehtë dhe më të këndshme.

Prandaj, për të studiuar te NE, ju do të jeni më afër realitetit Dinamik të jetës, do të njiheni me materialet e ndërtimit, llojet e objekteve, shërbimeve të shpejta gjeodezike, hidrologjinë, hidroteknikën, ambientin duke vlerësuar ligjet natyrore të fizikës.

## **Fakulteti i Ndërtimtarisë ju ofron;**

Ambiente të përshtatshme, atraktive dhe komode për të studiuar. Laboratorë profesional për shqyrtime, matje, eksperimente dhe shërbime tjera. Zhvillime bashkëkohore dhe moderne të mësimdhënies duke krijuar lehtësi për mësimnxënie cilësore dhe të shpejt.

*Pse unë duhet të studioj inxhinierinë e ndërtimit pranë Fakultetit të Ndërtimtarisë ?*

